

**BASHKIA ELBASAN**  
**NJOFTIM PËR DHËNIE ME QIRA**

1. Publikimin në Buletinin e Njoftimeve Publike të procedurës për dhënien me qira me anë të konkurimit të pasurisë nr.1/2, e lloji “ Tokë e P.F” , me indeksi harte K-34-101-(149-B,150-A), ZK.2355, Njësia Administrative Labinot –Fushë , në pronësi të Bashkisë Elbasan, me të dhënat si më poshtë vijon:

- Objekti Tokë e pafrytshme
- Sipërfaqja 10382 m<sup>2</sup>
- Zona Kadastrale 2355
- Çmimi dysheme 27.000 (njëzeteshtatë mijë) lekë/ha në një vit kalendarik

2. Pasuria e përcaktuar sipas pikës 1, jepet me qira me qëllim ushtrim aktiviteti për qëllime blegtorale, bujqësore, kulturore, industriale etj., sipas objektit të veprimtarisë së subjektit qiramarrës, që përmirësojnë pronën dhe sjellin të ardhura për Bashkinë Elbasan .

3. Afati i dhënies me qira është 20 (njëzetë) vite.

4. Vlerësimi i ofertave të konkurrentëve do të bëhet me pikët si vijon:

- Investimi 50 pikë;
- Punësimi 30 pikë;
- Tarifa mujore e qirasë 20 pikë;

5. Konkurrimi do të zhvillohet më datën 15.07.2020, në orën 11:00, në ambientet e Bashkisë Elbasan.

6. Konkurentët do të paraqesin para komisionit në datën dhe orën e caktuar sipas pikës 5 të këtij urdhëri, dokumentacionin si vijon:

a) kërkesën e subjektit për marrje me qira të pasurisë shtetërore ku të deklarohej oferta për vlerën e detyrimit mujor të qirasë, qëllimi i marrjes në përdorim të pronës shtetërore si dhe treguesit e konkurimit të parashikuar sipas planit të biznesit

b) planbiznesin e hollësishëm për vënien në funksionim të objektit, ku të përfshihet informacioni i mëposhtëm:

- Identiteti i subjektit kërkues, historiku dhe aktiviteti që kryen;
- Përshkrimi i projektit të investimit, i punimeve që do të realizohen, i shërbimeve që do të ofrohen, i burimeve financiare të investimit;
- Analiza e detajuar e afateve kohore, që do të duhen për të realizuar projektin investues si dhe fazat e përcaktuara të realizimit të tij;
- Niveli i punësimit që do të realizohet sipas fazave kohore të përcaktuara
- Nëse kërkesa e subjektit është për një afat kohor mbi 5 vjet, plani i biznesit të jetë i përshkruar hollësisht, me të dhënat për 5 vitet e para të aktivitetit dhe parashikimin për periudhën tjetër

c) deklaratat në formën e vetëdeklarimit si më poshtë:

- Deklaratë për të dhënat e NIPT/NUIS të subjektit kërkues
- Deklaratë për shlyerjen e detyrimeve tatimore dhe sigurimeve shoqërore
- Deklaratë për administratorin dhe subjektin juridik ofertues, nëse është në ndjekje penale, si

dhe nëse ka procese gjyqësore në lidhje me aktivitetin;

- Në rast se subjekti konkurrues zhvillon aktivitete me qira në objekte pronë shtetërore, deklaratë për shlyerjen e detyrimeve, në të kundërt të theksojë se nuk ushtron aktivitet në objekte shtetërore;
- Deklaratë se mban përgjegjësi ligjore për vërtetësinë e deklarimeve në dokumentacionin e dorëzuar në konkurrim.

Ofertat dorëzohen me zarf të mbyllur në zyrën e Protokollit pranë Bashkisë Elbasan.